



Nr. 513  
Më: 11.01.2021

### Teatri Profesional “Adriana Abdullahu”-Ferizaj

Në bazë të rregullores së MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve , ligjin për teatrot me nr. 04/L – 106, si dhe Statutit të Teatrit Profesional “Adriana-Abdullahu” të Ferizajt.

## THIRRJE PUBLIKE

Teatri Profesional “Adriana Abdullahu”, ka paraqitur pranë DKRS-së planprogramin për vitin 2021, dhe me këtë rast u bën thirrje të gjithë OJQ-ve të dorëzojnë propozim-projektet e tyre për shfaqje teatrore.

### Dokumentet që duhet dorëzuar:

1. Përshkrim në jo më shumë se një faqe të projektit (teksti me të cilin aplikohet, numri i aktorëve dhe numri i personave të tjerë brenda ekipës kreative që duhet të angazhohen dhe informacione të tjera që i konsideroni relevante).
2. Platformë regjisoriale (platformë përmes të cilës regjisori shpjegon shkurtimisht konceptin e tij të përgjithshëm të shfaqjes).
3. Deklarata autoriale e regjisorit (deklarata e shkurtë me të cilën regjisori garanton origjinalitetin dhe autenticitetin e shfaqjes duke marrur përgjegjësinë për te).
4. Biografinë dhe CV e regjisorit.
5. Deklarata e autorit të tekstit (Nëse teksti është kombëtar, kjo deklarata formalisht i jep të drejtën regjisorit të konkurojë me tekstin e autorit përkatës, por e kufizon në realizimin e të njëjtës deri në kohën që projekti nuk miratohet nga këshilli drejtues i teatrit sipas kësaj thirrje publike. Në këtë rast Teatri “Adriana Abdullahu” merr të drejtën për të nënshkruar kontratë me autorin e veprës ose agjencionin që e përfaqëson atë. Nëse autori ka më tepër se 70 vjet që nuk është gjallë, të drejtat e veprës së tij nuk janë të obligueshme).

Propozim-projekti për shfaqje teatrore duhet të dorëzohet në kopje fizike me zarf në zyrën pritëse në Komunën e Ferizajt, si dhe në e-mail: [teatriadriana@gmail.com](mailto:teatriadriana@gmail.com), deri më 29.01.2021 në ora 16:00. Udhëheqësi artistik i Teatrit, do t’ia paraqes këshillit drejtues të teatrit të gjitha propozim-projektet konkurruese për vlerësimin dhe nxjerrjen e rezultatit.

Shfaqjet e realizuara në kuadër të kësaj thirrjeje publike, do të jenë pjesë e repertorit të rregullt të këtij institucioni për vitin 2021 – 2022.

OJQ-të duhet të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të si dhe të kenë të përmbyllura të gjitha detyrimet paraprake. Poashtu para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës i OJQ-së dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

- Projekt-propozimet e dorëzuara nuk do të shqyrtohen nëse nuk i përmbajnë të gjitha dokumentet e lartpërmendura.

Xhemile Murati-Shabani

Drejtoreshë e DKRS-së

